

Adoleshentët me sjellje ngacmuese dhe dinamikat familjare - Ndryshimet pas trajtimit me Terapi sistemike familjare

Drita Gashi Bytyçi

Njësia e Shëndetit Mendor për Fëmijë dhe Adoleshentë, Prizren

Hyrje

Terapia sistemike familjare është një lloj i psikoterapisë, që bazohet në teorinë se të gjitha llojet e vështirësive në individë, të paktën pjesërisht shpjegohen me disfunksionet në sistemin familjar dhe sistemet e tjera të cilave individi u përket. Modeli Integrativ bazohet në teorinë se çdo lloj problemi i sjellur në terapi, funksionon si një ndërlikim kompleks e faktorëve që u përkasin sistemeve përbrenda dhe jashtë individit. Sistemi familjar është një nga këto.

Qëllimi

Ky studim shqyrton lidhjen ndërmjet ngacmimit dhe familjes, si dhe jep të dhëna mbi ndryshimet pas trajtimit me Terapi sistemike familjare-Modelin Integrativ, si një qasje kulturore e ndjeshme.

Metodologjia

36 adoleshentë jashtëspitalor, ndërmjet moshës 14-16 vjeç, të cilët shfaqën sjellje ngacmuese për të paktën 6 muaj, janë përfshirë në studim. 18 adoleshentë u caktuan rastësisht në Grupin e Terapisë Familjare (G-TF), dhe 18 në Grupin e Kontrollit (GK). Ne ramë dakord mbi përgjegjësitë dhe çështjet etike, dhe e bëmë kontratën terapeutike. G-TF u trajtua me Modelin Integrativ për 6 muaj, me fokus në: qëllimet dhe planet e afërsisë-kontrollit, virusët në plane, emotiven, si dhe lidhjet ndërmjet programeve të anëtarëve të familjes. GK u trajtua me të njëjtën frekuencë si G-TF, por me fokus në: një studim të detajuar të shëndetit mendor, ndjenjat, rutinat e përditshme, si dhe ngjarjet e jetës. Çdo muaj, të dhënat janë mbledhur përmes intervistave, pyetësorëve, teknikave lehtësuese të observimit dhe observimeve të terapisë familjare të lojës.

Përfundimi

Lidhjet negative midis komunikimit familjar dhe sjelljeve ngacmuese sugjerojnë rëndësinë e adresimit të interaksioneve familjare në përpjekjet për parandalimin e ngacmimit në të ardhmen.

Literatura

[1] Ariel Sh., Keith D., Martinez-Ortiz D., Prosky Ph., Shi L., Tiurean A., & Whiteside R. (2014). Family Therapy Around the World. The Birth of Family Therapists: The Kosova Systemic Family Therapy Training Program. *Journal of Family Psychotherapy*, 25, 225–245.

[2] Aubrey L. Spriggs, M.A., Ronald J. Iannotti, Ph.D., Tonja R. Nansel, Ph.D., Denise L. Haynie, Ph.D., M.P.H. Adolescent Bullying Involvement and Perceived Family, Peer and School Relations. *Journal of adolescent Health*, 2007. 41, 3, 283–293

Bullying adolescents and family dynamics - Changes after treatment with Multi-systemic family therapy

Drita Gashi Bytyçi

Child and Adolescent Mental Health Unit, Prizren

Background

Multi-systemic family therapy is a type of psychotherapy that base on the assumption that all kinds of difficulties in individuals is at least partly explained by dysfunctions in the family system and other systems to which the individual belongs. The Integrative Model is based on the assumption that every problem brought to therapy is a function of a complex interaction of factors belonging to systems inside and outside the individual. Family system is one of these.

Purpose

This study examined associations between bullying and family and provides data for changes after treatment with Family therapy-Integrative Model, as a culturally sensitive approach.

Methods

36 outpatient adolescents, between 14-16 years of age, who exhibited a bullying behavior that lasted at least 6 months, were included in the study. 18 adolescents were randomly assigned to the Family Therapy Group (FT-G), and the remaining 18 to the Control Group (CG). We agreed on the responsibilities and ethical issues, and made therapeutic contract. The FT-G was treated with Integrative Model for 6 months, focusing on: proximity-control goals and plans, bugs in the plans, emotives, and types of relations between family members programs. The CG was treated with the same frequency as the FT-G, but focusing on: a detailed survey of their mental health, adolescents' feelings, daily routines, and life events. Every month, data were collected through interviews, questionnaires, observation facilitating techniques and observations of a family play therapy sessions.

Conclusion

Negative associations between family communication and bullying behaviors suggest the importance of addressing family interactions in future bullying prevention efforts.

References

- [1] Ariel Sh., Keith D., Martinez-Ortiz D., Prosky Ph., Shi L., Tiurean A., & Whiteside R. (2014). Family Therapy Around the World. The Birth of Family Therapists: The Kosova Systemic Family Therapy Training Program. *Journal of Family Psychotherapy*, 25, 225–245.
- [2] [Aubrey L. Spriggs](#), M.A., [Ronald J. Iannotti](#), Ph.D., [Tonja R. Nansel](#), Ph.D., [Denise L. Haynie](#), Ph.D., M.P.H. Adolescent Bullying Involvement and Perceived Family, Peer and School Relations. *Journal of adolescent Health*, [2007](#). 41, 3, 283–293.